



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE  
SEKTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

**Lënda:** Dërgim relacion shpjegues për Monitorimet

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e viti 2021”, udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ju dërgojmë raportet e monitorimeve për vitin 2021.

Gjatë periudhës vitit 2021, programi Instituti i Mjekësisë Ligjore, ka realizuar punën dhe politikën e tij e ka mbështetur mbi një qëllim, konkretisht:

***Qëllimi*** – *Përmirësimi në fushën e toksikologjisë dhe të anatomisë patologjike, duke u përafruar me standardet metodike dhe tekniko-shkencore të analogëve të Bashkimit Europian..*

Nga ana tjetër, IML ka përmbushur politikën e programit të vet duke shfrytëzuar fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2021. Buxheti fillestar i akorduar në zbatim të Ligjit Nr.137, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, për Institutin e Mjekësisë Ligjore është **81,000,000 lekë**, me shkresën nr.1381/15, datë 11.02.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është miratuar shtesa e fondit të veçantë **200,000 lekë**. Buxheti i rishikuar është **81,200,000 lekë**.

Buxheti (sipas planit të rishikuar)	81,200,000 lekë
Realizimi faktik (viti 2021)	72,757,336 lekë

Sa i takon buxhetit në nivel artikulli, gjatë vitit 2021, nuk ka pasur ndryshime. Buxheti në nivel artikulli gjatë vitit 2021, paraqiten si më poshtë:

<b><i>Artikulli 600+601 (Shpenzime personeli)</i></b>	
Buxheti (sipas planit të rishikuar)	39,000,000 lekë
Realizimi faktik (viti 2021)	34,953,765 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Artikulli 602+606 (Shpenzime te tjera operative)

Buxheti (sipas planit të rishikuar)	41,200,000 lekë
Realizimi faktik (viti 2021)	36,804,121 lekë

Artikulli 231 (Investime-Kapitale të trupëzuara)

Buxheti (sipas planit të rishikuar)	1,000,000 lekë
Realizimi faktik (viti 2021)	999,450 lekë

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2021 për Institutin e Mjekësisë Ligjore, sipas zërave kryesorë është:

- Shpenzimet e personelit 90 %
- Shpenzimet e tjera operative 89 %
- Shpenzimet kapitale 100 %

Realizimi i shpenzimeve të personelit është rreth 90%, për shkak të 6 vende vakante( 1 ekspert mjekoligjor dhe 1 psikiatër-ligjor me kategori page III-a/1, një Specialist Financë-Buxheti me kategori page IV-a dhe dy Specialistë pranë Laboratorit të Histopatologjisë me kategori page IV-b)

Shpenzimet operative janë realizuar 89%, në këtë zë kryhet çdo vit procedura e prokurimit për blerje karburanti (tender i përqëndruar) që realizohet nga Ministria e Brendshme. Për vitin 2021 ishte parashikuar në shumën 2,500,000 që zë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet operative, por edhe pse paraqitëm kërkesën për blerje karburanti, kërkesa jonë nuk u përfshi në tenderin e përqëndruar.

Për vitin 2021 për të realizuar objektivat dhe për të përmbushur qëllimin e IML-së, kemi planifikuar produktin e akteve të ekspertimit. Janë kryer 14,616 akte ekspertimi të planifikuara për vitin 2021.

Shpenzimet kapitale janë realizuar 100%, është parashikuar projekti “Blerje pajisje autopsie dhe laboratorike”, i cili është realizuar plotësisht. Janë blerë 8 pajisje autopsie. Gjithashtu për vitin 2021 u realizua projekti “Blerje pasjisje elektronike, printera” dhe është realizuar plotësisht. Janë blerë 3 printera.

**DREJTORI**

**Dr. Shk.Bledar XHEMALI**